

UDHEZIM

Nr. 2472, date 06.12.2006

PER ZBATIMIN E VKM NR. 618, Datë. 07.09.2006 PER PERCAKTIMIN E KRITEREVE, TE DOKUMENTACIONIT DHE MASES SE PERFITIMIT TE PAGESES PER PERSONAT ME AFTESI TE KUFIZUARA

Mbeshtetur ne piken 4, te nenit 102, te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, ne zbatim te ligjit Nr. 9355 date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore", te pikes 27 te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 618 date 07.09.2006 "Per percaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe masas se perfitimit te pageses per personat me aftesi te kufizuar",

UDHEZOJ:

1. Administratori shoqeror ne bashki, komune, ne perputhje me kriteret dhe treguesit, programon kerkesat per fonde per pagesen e personave me aftesi te kufizuar e dergon ne Zyrat Rajonale te Sherbimit Social Shteteror.
2. Programimi i fondeve per pagesen e personave me aftesi te kufizuar behet per çdo grup ne veçanti ne perputhje me nenin 7 dhe 8 te ligjit 9355 date 10.03.2005, i ndryshuar, per para dhe tetraplegjiket, per personat me aftesi te kufizuar fizik e mendore, per invalidet e punes si dhe per paketen e vecante higjeno-sanitare per invalidet paraplegjike dhe tetraplegjike.
Programi i fondeve per te verberit behet ne perputhje me Udhezimin Nr. 1956, date 19.09.2006.
3. Fondet e nevojshme per te gjithë grupet e PAK te bashkise/komunes perllogariten ne baze te numrit te personave me aftesi te kufizuara per secilin grup te vleresuar sipas vendimit te KMCAV/KMPV dhe mases se perfitimit per secilin kategori.
Per te gjitha kategorite mbahen parasysh pagesat e diferencuara qe perfitojne individe te veçante per periudhen kur ndjekin arsimin te mesem, te larte apo mbas universitar.
Te dhenat e mesiperme plotesohen sipas Mod.1 bashkelidhur ketij udhezimi.
4. Njesite vendore, kerkesat per fondet e programojne sipas mod. 1, i dorzojne ne zyrat rajonale te Sherbimit Social Shteteror ne fund te muajit qershor te vitit ne vazhdim.
5. Zyrat Rajonale te Sherbimit Social Shteteror vleresojne kerkesat ne perputhje me kriteret ne fuqi dhe hartojne nevojat per fondet e pageses se PAK ne nivel qarku, dhe sebashku me Mod.1 per secilin bashki/komune, brenda dates 10 korrik i dergon ne Drejtorise se Pergjithshem te Sherbimit Social Shteteror.
6. Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimit Social Shteteror, vlereson kerkesat e ardhura nga rajonet dhe programon fondet per projektbuxhetin e vitit pasardhes ne nivel kombetar te cilin e percjell ne Ministrine e Punes Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta.

7. Ne fund te muajit nentor te vitit ne vazhdim bashkite/komunat, perditesojne kerkesat per fonde sipas mod.1, dhe i paraqesin ne Zyrat Rajonale te Sherbimit Social Shteteror.
8. Zyrat Rajonale, keto kerkesa i percjellin brenda dates 10 dhjetor ne Drejtorine e Pergjithshme te Sherbimit Social Shteteror.
9. Sherbimi Social Shteteror ben detajimin e fondeve te programuara per PAK sipas ligjit te buxhetit te vitit pasardhes per çdo bashki/komune dhe e percjell ne Ministrine e Punes Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta.
10. Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta ben trasferimin e fondeve si grante te kushtezuara per çdo bashki/komune per vitin pasardhes ne perputhje me ligjin e buxhetit dhe udhezimin e Ministrit te Finances ne zbatim te ketij ligji.”
Ky udhezim hyn ne fuqi me botimin ne Fletoren Zyrtare.

Ministri

Koço Barka